



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 445/24 Dt. 19.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Themelohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga fermerët të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: “Furnizim me mëshqerra gravide” me bashkëfinancim dhe për projektin: “Ngritja e stallave për lopë qumështore”, me bashkëfinancim. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Nijazim Mustafi,..... kryesues,
 - 1.2. Muhamet Bajrami,.....anëtar,
 - 1.3. Xhevdet Dervishaj,.....anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj, vlerësoj dhe vendos të gjitha ankesat e ardhura nga ana e fermerëve të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: “Furnizim me mëshqerra gravide”, me bashkëfinancim dhe për projektin: “Ngritja e stallave për lopë qumështore”, me bashkëfinancim”, dhe të njëjtit nuk janë shpallur fitues nga ana e Komisionit që ka bërë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të fermerëve në bazë të thirrjes për projektet e lartcekura.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Komisionit të lartcekur,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

